

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E LLOJEVE TË SINJALEVE TË ALARMIT, NUMRIT DHE MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË TYRE, NË RASTET E FATKEQËSIVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka si qëllim përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe përcakton kushtet për miratimin edhe përshtatjen e tyre në Sistemin e Mbrojtjes Civile, sipas specifikimeve përkatëse.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe as me dokumente të tjera politike.

Projektvendimi është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2021.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektvendim është i domosdoshëm, pasi nëpërmjet tij synohet miratimi i sinjaleve të alarmit, me qëllim njoftimin e hershëm të popullsisë dhe marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen nga fatkeqësitë.

Projektvendimi përcakton bashkëpunimin ndërinstitucional, të cilët nxjerrin udhëzime lidhur me kushtet e përzgjedhjes së vendeve ku do të vendosen sinjalet e alarmit dhe strukturat e sistemit të mbrojtjes civile dhe institucioneve dhe strukturave që në fushën e përgjegjësisë së tyre shtetërore kanë kompetenca për monitorimin dhe mirëmbajtjen e këtyre sinjaleve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në harmoni të plotë me rendin e brendshëm juridik dhe atë ndërkombëtar. Projektvendimi propozohet në bazë të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 50, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, ku përcaktohet se “Llojet e sinjaleve të alarmit, numri dhe mënyra e përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit”.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi del në zbatim të pikës 4, e nenit 50, të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" dhe përbëhet nga 10 pika.

Sipas pikës së parë, objekti i këtij projektvendimi është miratimi i llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre në rastet e fatkeqësive, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Pika e dytë e këtij projektvendimi përcakton se sinjalet e alarmit duhet të jenë të thjeshta dhe të kuptueshme nga të gjitha kategoritë e popullsisë, me qëllim që të shmanget diskriminimi karshi personave me aftësi ndryshe, për të cilët strukturat përgjegjëse për përcaktimin e alarmeve duhet të sigurohen që këto alarme të jenë të kuptueshme. Ky përcaktim është në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", e cila parashikon se "Llojet e sinjaleve testohen, me qëllim që të jenë të komunikueshme për kategoritë e mëposhtme të personave:

- a) me vështirësi në dëgjim, me anë të shenjave pamore;
- b) me vështirësi në shikim, me anë të sinjaleve akustike dhe të prekshme;
- c) me kufizime intelektuale, në formate të thjeshtuara, përmes mesazheve me piktograme ose gjuhë e thjeshtë në media."

Pika e tretë përcakton kategoritë të sinjaleve të alarmit, të cilët janë:

1. sinjale pamore;
2. sinjale zanore;
3. sinjale informatike dhe elektronike të lëvizshme (infomobiliteti).

Për secilën kategori janë përcaktuar edhe nënndarjet përkatëse.

Pika e katërt e projektvendimit përcakton se në varësi të shtrirjes territoriale, autoriteti përgjegjës për caktimin e vendeve ku do të vendosen sinjalet e alarmit, për ruajtjen dhe mbajtjen në gatishmëri, do të jetë prefekti i qarkut, në bashkëpunim me kryetarin e bashkisë. Kjo pikë është riformuluar sipas sugjerimit të Ministrisë së Drejtësisë për të shmangur një konflikt të mundshëm kompetencash gjatë zbatimit të normës në praktikë.

Pika e pestë e projektvendimit vendos detyrimin e subjekteve private që në rastet kur sinjalet e alarmit vendosen në prona e tyre, këta të fundit janë përgjegjës për ruajtjen e sinjaleve dhe kanë detyrimin e lejimit të personelit të ngarkuar me mirëmbajtjen. Komenti i Ministrisë së Drejtësisë mbi këtë pikë nuk pranohet, pasi vlerësojmë se përcaktimi është në përputhje me dispozitën autorizuese në të cilën përcaktohen shprehimisht detyrimi i subjekteve private në lidhje me instalimin dhe aktivizimin e sinjaleve të alarmit në rast nevojë. Në gjykimin tonë është e nevojshme parashikimi i detyrimit për lejimin e personave përgjegjës në ambientet e pronës private, pasi në rast se parashikimi do të hiqej, në praktikë mund të hasen probleme me zbatimin efektiv të projektvendimit.

Në pikën gjashtë të projektvendimit përcaktohet se kohëzgjatja e përdorimit të sinjaleve të alarmit duhet të përkojë me kohëzgjatjen e fatkeqësisë.

Pika shtatë e projektvendimit përcakton autoritetin përgjegjës për aktivizimin e sinjaleve të alarmit, të cilët në varësi të shkallës së rrezikut dhe të shtrirjes territoriale, do të aktivizohen nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, prefekti i qarkut ose kryetari i bashkisë, në bashkërendim, sipas situatës konkrete me Autoritetin e Mediave Audiovizive, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare ose Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.

Në pikën tetë përcaktohet se përdorimi i sinjaleve bëhet i kombinuar për informimin e të gjitha kategorive të popullsisë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi do të ngarkohen institucionet dhe strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Projektvendimi është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Kulturës.

Gjithashtu, projektvendimi do të dërgohet për mendim pranë Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, Autoritetit të Mediave Audiovizive, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Institutit të Gjeoshkencave Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare të këtij projektvendimi, sipas tabelës bashkëlidhur do të mbulohen nga buxheti i shtetit akorduar bashkive brenda fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile.



MINISTRI I MBROJTJES

Niko Peleshi

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive".

Tabela

e kostos financiare të implementimit të VKM-së “Për e llojet e sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive”

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Cmimi (Lekë)	Shuma (Lekë)
1	Tabelat vertikale elektronike për dhënie e mesazheve të ndryshueshëm alfanumerikë me instalime të paracaktuara ose të lëvizshme	Copë	610	20000	12,200,000
2	Tabelat vertikale statike me figura dhe mesazhe paralajmëruese me instalime të paracaktuara ose të lëvizshme	Copë	915	1500	1,372,500
3	Sinjale fumogjene ose raketore (në rastet e rrëshqitjeve të dherave ose ortekëve të borës)	Copë	1000	1000	1,000,000
4	Sirena statike ose të lëvizshme	Copë	550	12000	6,600,000
5	Sisteme të fonisë së lëvizshme	Copë	30	10000	300,000
6	Mesazhe elektronike me sms, mesazhe të pararegjistruara nga call centers, e-mail, portalet web etj..	Copë	1	15000	15,000
7	Mesazhe vizive në portale të improvizuara, kioskat web (zonat turistike etj..), tabelave elektronike reklamuese, qendrat WiFi etj..	Copë	1	20000	20,000
8	Sinjale të transmetimit Radio nëpërmjet Stacioneve Kombëtare Radio	Copë	1	50000	50,000
9	Sinjale të transmetimit TV nëpërmjet Stacioneve Kombëtare TV dhe Portaleve TV të informacionit	Copë	1	250000	250,000
10	Sinjale të transmetuara nga stacione permanente apo të lëvizshme me sisteme	Copë	122	20000	2,440,000
					24,247,500